



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1142/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. K1o9/17

Parashtrues

Fatmir Hoti

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 281/2016, të 5 dhjetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fatmir Hoti, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 281/2016, i 5 dhjetorit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 421/2016, i 9 shtatorit 2016 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë (Aktgjykimi PKR. nr. 23/2014, i 16 majit 2016).
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 dhjetor 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive), si dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 shkurt 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
7. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gérxhaliu-Krasniqi.
8. Më 27 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 8 maj 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
10. Më 5 shtator 2017, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegi shqyrtues i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përbledhja e fakteve

11. Më 16 maj 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë (me Aktgjykimin PKR nr. 23/14) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale kontraktim i përfitimit joproportional dhe e gjykoj me dënim me burg.
12. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Ankesën e ushtroi edhe Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda.
13. Më 9 shtator 2016, Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin PAKR nr. 42/16) e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.
15. Më 5 dhjetor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës (me Aktgjykimin PML. nr. 281/2016) e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij për barazi para ligjit, mjet efektiv juridik, gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtje të pronës dhe mbrojtje gjyqësore e të drejtave.
17. Parashtruesi i kërkesës konsideron se: "*Shkelja ka të bëjë në atë se përbërja e gjykatës së shkallës së parë nuk ka qenë në pajtim me ligjin, që paraqet shkelje nga neni 384. par. 1 nënparr. 1.1. të KPPRK. Në përbërje të Trupit gjyques në Gjykatën e shkallës së parë kanë marrë pjesë edhe gjyqtaret [...], që punojnë në Divisionin për kundërvajtje të Gjykatës Themelore në Gjakovë, si gjyqtare kundërvajtëse, të cilat nuk i përbushin kushtet ligjore për të gjykuar në çështje që janë në kompetencë të Departamentit për krimet të rënda*".
18. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se: "*Edhe pse me aktgjykimin e shkallës së parë dhe ai ankimore ka pasur shumë shkelje esenciale [...], Gjykata e Apelit fare nuk i ka analizuar këto shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe pa kurrrafarë arsyeshmërie ka refuzuar ankesat tonë dhe e ka vërtetuar aktgjykin e shkallës së parë*".
19. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se: "*në lidhje me shkeljet e cekura, Gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet për të cilat ka konsideruar se janë të vërtetuara përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari Fatmir Hoti ka kryer vepër penale për të cilën është gjykuar, gjithashtu gjykata nuk i ka vërtetuar provat kundërthënëse dhe pse disa provave iu ka falë besimin, gjersa disa provave tjerave jo dhe Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyera të mjaftuara, nga se Aktgjyki i Gjykatës Supreme kryesisht*

është narrativ lidhur me rrjedhjen e procedurës, nga arsyerat e dhëna nga Gjykata nuk janë të mjaftuara”.

20. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të:

- I. DEKLAROHET** kërkesa e pranueshme;
- II. KONSTATOHET** se ka pasur shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6.1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 5 dhe 6 [E drejta për një proces të rregullt], nenin 12, 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së, nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave];
- III. SHPALL** të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 281/2016 të datës 5.12.2016;
- IV. KTHEN** Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese;
- V. URDHËRON** që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- VI. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.**

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 (Juridiksi dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
23. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili thotë:

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.

25. Gjykata më tej i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnje mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatin prej 4 (katër) muajve siç përcaktohet në nenin 49 të Ligjit.
27. Gjykata gjithashtu do të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës ka sqaruar saktë dhe ka specifikuar pretendimet në pajtim me nenin 48 të Ligjit.
28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka qartësuar saktësish të drejtat që pretendon se janë shkelur, si dhe aktin konkret të autoritetit publik.
29. Sa i përket zbatueshmërisë së rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b), Gjykata konsideron se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës është:
- (i) Gjykata Themelore ka vendosur në mënyrë të paligjshme sepse përbërja e saj nuk ka qenë siç duhet;
 - (ii) gjykatat e rregullta nuk kanë vërtetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë gjendjen faktike, dhe, rrjedhimisht, vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë analizuar dhe arsyetuar në mënyrë adekuate.

30. Sa i përket pretendimit (i), Gjykata vëren se Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 281/2016) e ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

31. Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj konstatoi: “*nga procesverbalet të shqyrtimit gjyqësor del se palët e as mbrojtësit e të dënuarit, nuk kanë pas vërejtje në përbërjen e trupit gjykues, e nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 14.03.2016 në të cilin anëtarët kanë qenë gjyqtarët e emëruar, decidivisht kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje në përbërjen e trupit gjykues.*

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1 të KPPK-së bëhet kur përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka

marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi. Kjo në rastin konkret nuk ka ndodhur. Konform dispozitës së nenit 12 par. 4 të Ligjit për gjykatat, Kryetari i Gjykatës Themelore cakton gjyqtarët në departamente për të siguruar gjykim efikas të lëndëve dhe përkohësisht mund të ricaktojë gjyqtarët ndërmjet degëve dhe departamenteve sipas nevojës, që të adresohen konfliktet, të zgjidhen lëndët e prapambetura apo të sigurojë shqyrtim me kohë të çështjeve. Andaj, ky pretendim nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ishte i bazuar”.

32. Gjykata konsideron se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë marrë parasysh të gjitha pretendimet e cekura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda kufijve të caktuar me ligj. Ajo i është përgjigjur në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimeve dhe është arsyetuar pse kërkesa është refuzuar si e pabazuar. Shpjegimet dhe arsyet e paraqitura nuk janë rezultat i vërtetimit të paarsyeshëm të fakteve apo zbatimit arbitrar të së drejtës procedurale dhe materiale.
33. Sa i përket pretendimit (ii), Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore tregon një analizë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të të gjitha fakteve dhe ligjit në lidhje me kryerjen e veprave penale dhe caktimin e dënimit.
34. Gjykata thekson se Gjykata e Apelit ka shpjeguar në detaje dhe i është përgjigjur ankesës së parashtruesit, duke ofruar arsyetime të qarta në pretendimet e tij për shkelje esenciale të dispozitave të Kodit Penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për vendimin mbi dënimin.
35. Për më tepër, Gjykata e Apelit “në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik [të Gjykatës Themelore], duke vlerësuar se drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se ankesa [e parashtruesve të kërkesës] është e pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin [e Gjykatës Themelore]”.
36. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë vlerësuar faktet dhe i kanë interpretuar dhe zbatuar dispozitat e të drejtës procedurale dhe materiale në lidhje me kërkesën e parashtruesit. Konkluzionet e tyre u bazuan në ekzaminim të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesit dhe nga pala e démtuar.
37. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës përsëriti para Gjykatës të njëjtat argumepte që ai i kishte ngritur në procedurat në gjykatat e rregullta, në veçanti lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta.
38. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përvèç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe

materiale (Shih: *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28).

39. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih: GJEDNJ, rasti *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; shih, po ashtu: *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti KI86/11, parashtrues i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012).
40. Me fjalë të tjera, vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i drejtë i ligjit është brenda juridikSIONIT të plotë të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë).
41. Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk i jep të drejtë për të ngritur një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.
42. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih: *inter alia*, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
43. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrale dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih: *mutatis mutandis*: GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06).
44. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se e drejta në pronë zbatohet vetëm për pasuritë ekzistuese të një personi dhe nuk garanton të drejtën e fitimit të pronës (Shih: *mutatis mutandis*, GJEDNJ, rasti: *Marckx kundër Belgikës*, nr. 6633/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1879, paragrafi 50).
45. Në rrethana të caktuara, “*pritja legitime*” për fitimin e pasurisë mund të gjëzojë gjithashtu mbrojtje nga nenin 46 in Kushtetutës dhe nenin 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (Shih: *mutatis mutandis*, GJEDNJ, rasti *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, Aktgjykimi i 13 dhjetorit 2016, paragrafi 74).
46. Megjithatë, Gjykata rikujton se nuk mund të thuhet se “*pritshmëria legitime*” paraqitet në rastet kur ekziston një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të së drejtës vendore dhe kur parashtruesat e parashtruesve të kërkesave më vonë janë hedhur poshtë nga gjykatat kombëtare (Shih: *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, *Ibidem*, paragrafi 75).

47. Gjykata konsideron se rr Ethanat e rastit nuk i jepin parashtruesit të kërkësës titullin e interesit material të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
48. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkësës nuk i ka paraqitur faktet të cilat tregojnë se në procedurat para gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ka pasur shkelje të tij të garantuara me Kushtetutë për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës.
49. Si përbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkësës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
50. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkësën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

